



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 272/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Klinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Klinë, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugën publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Dega në Klinë, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 17.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 17.10.2013, në Rrugën “Skënderbeu” dhe në rrugën „Abedin Rexha“ pranë KEP bankës, rreth orës 12:00 anëtarë të subjektit politik AAK, kanë vendosur banerin e kandidatit të tyre mbi rrugën publike, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, neni 33 pika b) dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 18.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.10.2013, brenda afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë në të cilën theksohet se më të pranuar njoftimin për dukjen e banerit të kandidatit të AAK-së mbi rrugën publike, struktura menagjuese e fushatës, konkretisht shtabi zgjedhor për komunën e Klinës, ka bërë largimin e këtij baneri, dhe ka ofruar disa fotografi në të cilën dëshmohet veprimi i largimit të banerit të vendosur mbi rrugët publike të Klinës, nga persona të paidentifikuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografit të cilat gjenden në shkresat e lendes identifikohet qart se baneri i kandidatit të AAK-së për kryetar të Komunës në Klinë është i vendosur mbi rrugë publike siç pretendohet në ankesën me te cilin veprim subjekti politik AAK ka rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore te neni 33 pika b) të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se banerin e kandidatit për kryetar komune në Klinë kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e banerit. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se AAK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë fotografit nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e AAK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që banerin e kandidatit për kryetar të komunës të AAK-së janë vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik AAK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, neni 120 paragrafi 1 pika c), si dhe neni 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 272/2013 më datën 17.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*